

Thirrje Publike për Aplikime për Ngritjen e Kapaciteteve në Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjnor dhe përgjigjes së qëndrueshme nga Rrjeti i Mbikëqyrësve të Buxhetimit Gjnor

Referenca e Kërkesës Nr: 2841/02/23

Projekti: FUQIZIMI I TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES PËR BARAZINË GJINORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MOLDAVI (RRJETI I MBIKQYRJES SË BUXHETIMIT GJINOR (RrMBGj), FAZA II)

Financuar nga: Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Partnerët Zbatues: Centre for Research and Policy Making, Gender Alliance for Development Centre; Centre for Civil Society Promotion; Kosovo Women's Network; Women Action; Gender Knowledge Hub, Keystone Moldova

Rrjeti i Mbikëqyrjes së Buxhetimit Gjnor (RjMBGj) shpall Thirrjen Publike për Aplikime për Ngritjen e Kapaciteteve dhe Sub-Granting në Përgjigjen e Buxhetimit Gjnor dhe përgjigjes së qëndrueshme nga Rrjeti i Mbikëqyrjes së Buxhetimit Gjnor nga **Maqedonia e Veriut, Serbia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, dhe Moldavia.**

Pasqyra e Projektit

Qeveritë ende duhet t'i zbatojnë plotësisht zotimet ndaj Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjnor (BPGJ) dhe të institucionalizojnë BPGJ-në gjatë gjithë procesit buxhetor. Për më tepër, përfshirja e analizave gjinore dhe qasjes transformuese gjinore ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor (BP) dhe Moldavi është e kufizuar. Ndërkohë, edhe përse përfshirja e shoqërisë civile në barazinë gjinore dhe ndryshimet klimatike është rritur, kanë ekzistuar vetëm disa nisma ndërsektoriale që i prekin këto dy çështje. OShC-ve dhe politikëbërësve ende u mungojnë njohuritë, metodologjitë dhe aftësitë në BPGJ, veçanërisht në lidhje me ndryshimet klimatike dhe përgjigjet financiare të qëndrueshme e cila u dëshmuar me pandeminë COVID-19 kur pamjaftueshmëria e kapaciteteve për një përgjigje të transformuar gjinore ishte më se e dukshme.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit tonë të përbashkët është përmirësimi i angazhimeve publike për veprime klimatike të përgjigjshme gjinore dhe për të rritur financimin e disponueshëm për zbatimin e veprimit klimatik të përgjigjshëm gjinor në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë.

Rezultatet e parashikuara të projektit përfshijnë:

- Rritja e vizibilitetit dhe njohja ndërkombëtare e punës së Rrjetit të Mbikëqyrjes së Buxhetimit Gjinator;
- Rritja e kapaciteteve të OShC-ve për të përdorur mjetet e BPGJ-së për mbikqyrjen e politikave dhe financimit të ndryshimeve klimatike;
- Përmirësimi i pjesëmarrjes së OShC-ve në proceset e politikave dhe buxhetimit duke përdorur mbikëqyrjen buxhetore gjinore;
- Disponueshmëria e mjeteve për të rritur llogaridhënien e qeverisë, veçanërisht në përgjigje të qëndrueshme, financimin në lidhje me çështje të ndryshimeve klimatike dhe përgjigjshmërinë gjinore në kuadër të politikave të ndryshimeve klimatike;

Thirrja për Aplikime

Si advokues të drejtësisë dhe barazisë sociale, është thelbësore që OSHC-të të kenë njohuri të të avancuara të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe se si qeveritë duhet ta zbatojnë atë për të krijuar shoqëri më të barabarta. Prandaj, me këtë thirrje, ftojmë organizatat e shoqërisë civile nga Ballkani Perëndimor dhe Moldavia që të paraqesin një **koncept** projekti për **llojet e mëposhtme të granteve**.

- **Grante Kombëtare**- Dy (2) grante do të jepen për secilin vend të përfshirë në këtë projekt, me shumën maksimale prej €8,000 për grant. Projektet duhet të përfundojnë në një periudhë deri në tetëmbëdhjetë muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
- **Grante Rajonale** – Dy (2) grante do të jepen me shumën maksimale prej 25,000 € për grant. Projektet duhet të përfundojnë në një periudhë deri në njëzet e katër muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në total, 16 grante (2 për shtet dhe 2 rajonale) do të jepen në kuadër të këtyre skemave të granteve.

Koncepti duhet të lidhet me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe financimin e përgjigjes së qëndrueshme duke përfshirë analizën gjinore për të informuar shpenzimet, monitorimin e shpenzimeve duke përdorur analizën e ndikimit gjinor, ose duke përdorur mjete të tjera të [BPGJ-së](#). Çështjet e mundshme ku projektet mund të fokusohen mund të jenë, por jo domosdoshmërisht të kufizuara, me:

- Kriza energjitike
- Krizat e sigurisë që rrjedhin si pasojë e konfliktit Ukrainë-Rusi
- Kriza ushqimore
- Përgjigjja mbi emergjencat dhe fatkeqësitë
- Kriza mjedisore
- Efektet e rritjes së kostos së jetesës në barazinë gjinore

Pas përzgjedhjes, përfaqësuesit e secilës prej organizatave të fituese do të duhet të angazhohen për të ndjekur tre module trajnimi mbi buxhetimin e përgjigjshëm gjinor ku do të zhvillojnë njohuritë e tyre në lidhje me mjetet e ndryshme të BPGJ-së. Më pas, kjo njohuri do të shërbejë për të zhvilluar një projekt propozim të plotë, duke u ndihmuar dhe nga (mentorim) nga ekspertë të buxhetimit gjinor dhe mentorë të RrMBGj. Dy nga modulet trajnuese janë të disponueshme në Akademinë online të RrMBGj ([Bazat e BPGJ](#) dhe [BPGJ i Avancuar](#)) të ndërtaura veçanërisht për OSHC-të. Trajnimi i tretë mbi “Monitorimin e Përgjigjes së Qëndrueshme” do të organizohet në Mal të Zi në datat 16 - 19 Maj 2023. Organizatat aplikuese do duhet të përcaktojnë në aplikim një përfaqësues për të ndjekur dhe përfunduar këto trajnime, sidomos atë që do të zhvillohet në Malin e Zi. Pas përfundimit të trajnimeve, organizatat do të ftohen të paraqesin propozimet e plota për financim.

Kriteret për të aplikuar

Organizatat duhet të jenë të regjistruara ligjërisht në një nga 7 shtetet vijuese: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut¹, Moldavia, Mali i Zi dhe Serbia. Për këtë thirrje preferohen, por jo detyrimisht:

- **Organizata të të drejtave të grave** - organizatat që punojnë për të çuar më tej të drejtat e grave, si dhe ato që kanë një qasje ndërsektoriale në punën me gra të ndryshme, si gratë rurale, gratë me aftësi të kufizuara, të varfërit dhe personat me orientime seksuale dhe identitete të ndryshme gjinore.;
- **Organizata “Think tank”** - veçanërisht ato që ndër të tjera punojnë në reformat përkatëse për anëtarësimin në BE në reformat e arsimit reformat për moshën e tretë, rininë, administratën publike dhe financat publike.;
- **OSHC-të që punojnë mbi financat publike** (buxheti apo çështje të prokurimeve) – që merren me financat publike, monitorimin e buxhetit, dhe monitorimin e prokurimeve publike;
- **Organizatat Mjedisore** – që merren me çështjet mjedisore;
- **Organizatat e burrave** – organizata aktive në barazine gjinore dhe sfidat që prekin burrat;
- **Organizata që punojnë mbi zbatimin e Rezolutës 1325 të KB** dhe axhendës së grave, paqes dhe sigurisë

Për t'u kualifikuar për një grant, aplikanti kryesor dhe partnerët e tij duhet:

- Të përfundojnë dy modulet trajnuese online dhe të angazhohen në trajnimit e tretë në Malin e Zi (të gjitha shpenzimet mbi udhëtimin dhe trajnimin do të mbulohen nga organizatorët),

¹ (Vetëm për aplikuesit nga Maqedonia e Veriut) Ligji mbi Shoqatat dhe Fondacionet (Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut, Nr. 52, data 16.04.2010) Закон за здруженија и фондации (Службен весник на Република Македонија, бр.52, од 16.04.2010)

- të jetë person juridik,
- të jetë jofitimprurëse,
- të jetë regjistruar/themeluar të paktën 2 vite përpara publikimit të thirrjes, **si dhe**
- të jetë përgjegjës direkt për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit me partnerët e tyre, duke mos vepruar si ndërmjetës. Të jenë të gatshëm të jenë pjesë e procedurës së Vlerësimit të Kapaciteteve Organizative dhe Advokuese nëse përzgjidhen si fitues të grantit, të ndërtojnë Planin e Zhvillimit të Kapaciteteve bazuar në gjetjet e vlerësimit dhe në lidhje me projektin e propozuar, si dhe të punojnë për ta zbatuar atë si pjesë të projektit; **si dhe** për **Grantet Rajonale** të paktën 3 OSHC nga 3 shtete të ndryshme duhet të jenë pjesë e partneritetit, ku secila nga 3 OSHC-të duhet të plotësojë kriteret e mësipërme të pranueshmërisë.

Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikantët

Aplikanti kryesor nuk mund të dorëzojë më shumë se 1 aplikim për thirrjet kombëtare. Megjithatë, një aplikant për një grant kombëtar mund të jetë partner në 1 aplikim tjetër të thirrjes rajonale në të njëjtën kohë. Aplikantit kryesor mund t'i jepet më shumë se 1 grant sipas kësaj thirrjeje për aplikime (një herë sipas skemës kombëtare të subgranteve dhe së dyti si partner sipas skemës rajonale të nëngranteve).

LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME PËR APLIKIM NË FAZËN E KONCEPTIT

Dokumentet e mëposhtme duhet të dorëzohen në fazën e Konceptimit:

- [Formulari i Aplikimit dhe Koncepti i plotësuar \(Shtojca 1\)](#);
- Statuti i OShC-së dhe secilit partner të OShC-së (në grante rajonale);
- Pasqyrat financiare për dy vitet e fundit;
- Dokumentet regjistruese.

PROCESI

Aplikimi për Konceptin	Afati kohor
Publikimi i Kërkesës për Aplikime	20.03.2023
Sesioni Informativ (do të shpallet për secilin shtet veç e veç) -Shqipëria -Bosnja dhe Hercegovina - Maqedonia e Veriut -Mali i Zi - Moldavia - Kosova - Serbia	27-30.03.2023
Afati kohor për dorëzimin e aplikimit	07.04.2023
Shpallja e përzgjedhjes së grantmarrësve	25.04.2023
Përfundim i trajnimit online në akademinë e RrMBGj (dy module)	Jo më vonë se 10.05.2023
Mbikëqyrësit e BPGJ ndjekin trajnimin e OSHC për rimëkëmbjen pas COVID-19 në Malin e Zi	16-19.05.2023
Propozimet e plota të projekteve dhe buxhetet (modelet do të sigurohen pas përzgjedhjes së Konceptit	31.05.2023
Nënshkrimi i kontratës me përfituesit përfundimtarë dhe data e parashikuar e fillimit të projektit	01.07.2023

KRITERET E VLERËSIMIT TË KONCEPTIT

Si pjesë e vlerësimit administrativ, Konsorciumi rezervon të drejtën të verifikojë informacionin dhe dokumentet e paraqitura nga aplikantët, me ofruesit e autorizuar të këtyre shërbimeve dhe/ose institucionet shtetërore. Konceptet do të vlerësohen sipas kriterëve të përcaktuara më poshtë. Konceptet do të marrin një rezultat të përgjithshëm nga 30 pikë maksimale duke përdorur ndarjen sipas kornizës së vlerësimit më poshtë. Kriteret e vlerësimit ndahen në tituj dhe nëntituj. Çdo nëntitull do t'i jepet një pikë midis 1 dhe 5 si më poshtë:
1 = shumë dobët; 2 = dobët; 3 = pranueshëm; 4 = mirë; 5 = shumë mirë.

KRITERET	PIKËT	
1. Përshtatshmëria e Projektit	Nën-pikët	10
1.1 Sa i përshtatshëm është propozimi me objektivin e thirrjes për propozime? Sa i rëndësishëm është propozimi për temat specifike të deklaruara në thirrje?	5	
1.2 Sa i përshtatshëm është projekti për nevojat e identifikuarat të përfituesve përfundimtarë dhe grupeve të synuara, dhe a janë këto të zgjedhura dhe të përcaktuara qartë në mënyrë strategjike?	5	
2. Projekti	Nën-pikët	20
2.1 Sa bashkëkohor është paraqitja e përgjithshme e projektit? A përcaktohen në koncept rezultatet e pritura që do të arrihen nga projekti?	5x2	
2.2 Eksperienca dhe kapaciteti i OSHC, duke përfshirë dhe kapacitetet financiare	5	
2.3 Deri në çfarë mase përfshihen grupe të ndryshme si grupet e synuara dhe/ose përfituese, duke përdorur një qasje ndërsektoriale (p.sh., persona të moshave të ndryshme, gjinive, etnive, aftësive, feve, identiteteve, vendbanimit rural/urban dhe grupeve të marginalizuara.	5	
TOTALI I PIKËVE		30

DORËZIMI DHE AFATI

Formulari i plotësuar i aplikimit, koncepti dhe dokumentet duhet t'i dërgohen drejtpërdrejt menaxherit të granteve dhe nxënies të RrMBGj - Elena Acevska në adresën e mëposhtme të e-mailit: acevska@crpm.org.mk jo më vonë se 07.04.2023 COB.